## DETAJIME TE DYERVE TE BRENDSHME

### MENYRA HAPJE / OPENING SYSTEMS / TIPO DI APERTURA

**KLASIKE**

Kapaku i deres lidhet me nje kase te fiksuar me murin nepermjet menteshave qe lejojne levizjen e deres. Hapja behet ne brendesi te dhomes me te njejtat dimensione si te kapakut.



**LIBER**

Kapaku i deres perthyhet ne forme libri, ne raport 50/50 per te zene sa me pak hapesire brenda dhomes. Zgjidhja ideale per hapesirat e kufizuara.



**WALL IN**

Kapaku hapet ne menyre rreshkitese duke u inkastruar ne pjesen e brendshme te murit me gips. Struktura mbajtese e kesaj dere duhet te realizohet gjate punimeve te mureve ndarese.



**WALL OUT**

Kapaku hapet ne menyre rreshkitese pergjate siperfaqes se murit. Struktura mbajtese vendosen ne pjesen e jashtme te murit dhe ne varesi te deshires perdoret si element dekorues ose mbulohet me dekor te njejte si dera.



*Dere standarte*



*Dere me panel absorbues zeri*



### DETAJIME TE KONSTRUKSIONIT TE DYERVE

Kapaku eshte realizuar tamburat per te lehtesuar peshen dhe per te garantuar stabilitet ne jetegjatesi. Pjesa e jashtme eshte e veshur me MDF te trashesive te ndryshme 6/10 mm, ndersa struktura eshte konstruksion druri me ne qender karton hoje.
Kjo linje dere te lejon krijimin e modeleve te te ndryshme nga ana e dekorit. Pjesa e jashgtme realizohet me lyerje llakato mat dhe me shkelqim, PVC, leter si dhe remeso.

Kapaku, per te garantuar nje komfort akustik me te mire, realizohet me nje panel absorbues zeri me fibra druri.
Pjesa e jashtme eshte e veshur me MDF te trashesive te ndryshme 6/10 mm.
Kjo linje dere, ashtu si linja klasike,te lejon krijimin e modeleve te te ndryshme nga ana e dekorit. Pjesa e jashgtme realizohet me lyerje llakato mat dhe me shkelqim, PVC, leter si dhe remeso.